

A e dini se ?

- ▶ Në sallat e gjyqit të gjykatës së rrethit gjyqësor që ju mbulon, si dhe në atë përkatëse të apelit, funksionon Sistemi i Regjistrimit Dixhital Audio (RDA).
- ▶ Regjistrimi Dixhital Audio (RDA) i seancave gjyqësore është tashmë në dispozicionin tuaj, si pjesë e dosjes së çështjes gjyqësore.

Çfarë është Sistemi i Regjistrimit Dixhital Audio në Gjykata?

- ▶ Sistemi i Regjistrimit Dixhital Audio (RDA) mbështetet në një teknologji moderne që mundëson regjistrimin e të gjithë komunikimit gjatë një seance në sallën e gjyqit.
- ▶ Përdorimi i regjistrimit audio në gjykata është kërkesë e legjislacionit në fuqi.
- ▶ Shtrirja e Sistemit të Regjistrimit Dixhital Audio (RDA) në sallat e gjyqit është një nismë që po realizohet me mbështetjen e USAID-it, në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe gjykatat shqiptare.

Pse është i nevojshëm Sistemi i Regjistrimit Dixhital Audio në Gjykata?


- ▶ Sistemi i Regjistrimit Dixhital Audio (RDA) krijon procesverbalin fjalë për fjalë të seancave gjyqësore duke shmangur keqkuptimet dhe dyshimet mbi çfarë është diskutuar në sallën e gjyqit.
- ▶ Përdorimi i Sistemit të Regjistrimit Dixhital Audio (RDA):
 - Ndikon në rritjen e efektshmërisë dhe transparencës gjatë seancave gjyqësore.
 - Garanton një nivel më të lartë profesionalizmi dhe etike në sallën e gjyqit.
 - Mundëson rritjen e përgjegjshmërisë së sistemit gjyqësor ndaj publikut.

Si mund të pajiseni me kopje të regjistrimit audio të seancës gjyqësore?

- ▶ Çdo person i interesuar mund të marrë kopje të regjistrimeve të seancave gjyqësore, duke plotësuar formularin e kërkesës pranë sekretarisë së gjykatës.
- ▶ Dorëzimi i formularit duhet shoqëruar nga një CD e pahapur në kuti. Në kërkesën për kopje të regjistrimit dixhital audio duhet përcaktuar qartë arsyeja për të cilën bëhet kërkesa dhe lidhja me çështjen gjyqësore përkatëse.

Si trajtohet kërkesa për kopje të regjistrimit audio të seancës gjyqësore?

- ▶ Çdo kërkesë për kopje të regjistrimit audio shqyrtohet nga gjykata, e cila merr një vendim për pranimin ose jo të saj.
- ▶ Kopja jepet për t'u përdorur në përputhje me arsyen për të cilën është kërkuar dhe nuk duhet të keqpërdoret.
- ▶ Në rast refuzimi, gjykata shpjegon arsyet e këtij vendimi.



Sa kohë pas dorëzimit të kërkesës mund të pajiseni me kopjen e regjistrimit audio?

- ▶ Kur gjykimi është i përfunduar, kopja e regjistrimit audio të seancës gjyqësore mund të merret brenda 24 orëve nga kërkesa.
- ▶ Kur çështja është në proces, kopja e regjistrimit mund të merret brenda 48 orëve nga kërkesa.